

K O N T R A T E  
PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI  
TE KUFIZUAR "TRANSALBANIA" SH.P.K.



N D E R M J E T

1. TRANSSHQIPIT, person juridik shqiptar me qender ne Tirane, rr."Deshmoret e 4 Shkurtit" nr.6,e perfaqesuar nga Drejtori i saj z.Andon Hila (ketu me poshte do te quhet TR ):

DHE

2. KÜHNE & NAGEL BETEILIGUNGS-AKTIENGESELLSCHAFT, person juridik gjerman me seli ne 2800 Bremen 1,Wilhelm-Kaisen Brücke,e perfaqesuar nga z.Ralph Haberzettl me prokure te vecante (ketu me poshte do te quhet KN ).

Te dy palet bien dakort per sa me poshte :

NENI 1

Te krijojne nje shoperi me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "TRANSALBANIA" sh.p.k. (ketu me poshte do te quhet "Shoeria") Shoeria do ta kete seline e saj ne Tirane ne rrugen "Deshmoret e 4 shkurtit" nr.6.

NENI 2

Shoeria eshte person juridik dhe ushtron aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe vpron ne baze te legjisacionit shqiptar dhe konform kerkesave te kesaj kontrate dhe statutit qe i bashkangjitet.

Ortaket e shoferise jane pergjegjes per te gjitha detyrimet e tyre. Shoeria nuk mban pergjegjesi per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria e ortakeve te saj.

NENI 3

Objekti i shoferise do te jetet:

-Te rregulloje transportin si agjent spedicioni per te gjitha llojet e ngarkesave me det,ajer,toke,hekurudhe dhe rruge ose sherbime te kombinuara si dhe kryerjen e te gjitha sherbimeve te lidhura me to duke perfshire c'doganimin,magazinimin dhe paketimin.

-Te veproje si agjent anijesh,~~ngarkesash~~ ajrore e sikuracioni dhe dogane duke kryer te gjitha sherbimet e nevojeshme qe lidhen

me to.

-Te kryej transporte brenda dhe jashte vendit, per interesat e veta dhe te trete, me det, ajer, toke e hekurudhe me mjetet e veta dhe te te treteve.

NENI 4

Kapitali fillestar i shoqerise do te jetë 100.000 \$ US i ndare ne 200 kuota me vlerë 500 dollar secila.

Pjesmarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte 98 kuota ose 49 % nga TR dhe 102 kuota ose 51% nga KN. Te gjitha kuotat jane te regjistruara si pjesa te ortakeve.

Shoqeria mbani register te te gjithe ortakeve. Ne register shenohet emri dhe selia e secilit prej tyre.

NENI 5

Pas shlyerrjes se te gjitha detyrimeve tatimore sipas ligjit, fitimi neto i shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve ne masen 49% per TR dhe 51% per KN.

NENI 6

Ne rastin e transferimit me paramendim te kuotave nga nje ortak(Transferuesi) tek nje pale e trete ( I transferuari ), te gjitha pjeset e kuotave do ti neneshtrohen nje te drejte perparese te ortakve mbetes. Kjo e drejte do te aplikohet per te gjitha llojet e transferimeve me kontrate shitje, hipoteke, peng,, trashegimni, ose c'do forem tjeter.

E drejta e perparese nuk do te aplikohet per transferimin e pjezeve tek nje shoqeri ne te cilen transferuesi mbani direkt ose indirekt nje interes prej 100% (ose kur i Transferuari eshte anetar i grupit Kühne & Nagel ne shtete te ndryshme) me kusht qe i transferuari te zbatuje ligjet dhe rregullat e perfshira ketu sic ka rene dakort i transferuari.

NENI 7

Ushtrimi i te drejtis se perparese do ti neneshtrohet kushteve te me poshtme :

a) Jo me pak se 30 dite pune nga perfundimi i kontrates me te transferuarin, transferuesi duhet te beje njoftim per transferimin tek Administratoret me ane te nje letre rekomande te regjistruar duke vendosur cmimin dhe kushtet e transferimit. ne mirbesim. Ne te njeten kohe transferuesi duhet te njoftoje te transferuarin per egzistencen e te drejtis se perparese.



b) Administratoret do te njoftojne menjehere ortakun mund te caktuar per ushtrimin e te drejtes se perparese i cili mund ta ushtroje kete te drejte me anen e letres rekomande tek transferuesi duke i paraqitur nje kopje administratoreve brenda 30 diteve pas marrjes se njoftimit prej tij.

c) Ne rastin kur shqyrtimi eshte ne lloj dhe mund te paraqitet nga pala e trete, ortaku mbetes i caktuar per ushtrimin e te drejtes se perparese mund te veproje duke ofruar vleren e vertete te tregut ne lloj.

Kur vlera e vertete e tregut nuk mund te pranohet, brenda 30 diteve pune pas dates se njoftimit ajo do te vendoset nga ekonomisti i llogarive qe ka shqyrtuar bilancin e fundit te shoqerise para dates se njoftimit. Pasi cmimi te jete vendosur nga ekonomisti i llogarive, ortakut mbetes i fillon nje per-udhe prej 30 ditesh per ushtrimin e se drejtes se perparese, pasi te jete bere njoftimi me ane te letres rekomande.

d) N.q. se transferimi i pjeseve tek i transferuari ka per qellim te behet pa pagese, e drejta e perparese do te ushtrohet ne menyre te tille qe ortaku mbetes te kete te drejten per te ofruar pagesen e nje shume te barabarte me vleren e vertete te tregut.

e) N.q. se ortaku mbetes konsumon te drejten e tij te perparese sic eshte percaktuar ketu, transferuesi do te detyrohet te transferoje kontributet tek ortaku mbetes pa vonese ne kushtet e vendosura ne njoftim ose te percaktuara ndryshe.

f) N.q. se e drejta e perparese nuk eshte ushtruar, , transferuesi do te jete i lire te transferoje pjeset tek i transferuari duke i lajmeruar.

g) N.q. se ndonjeri prej ortakeve nuk e konsumon te drejten e perparese, brenda 30 diteve pune nga dita e njoftimit te kontrates, e drejta e perparese kalon tek ortaku mbetes i caktuar me te drejten e perparese ku do te aplikohet afat i ri per ushtrim. Transferuesi do te detyrohet te transferoje pjeset e ofruara tek ortaku mbetes qe ka ushtruar te drejtat e tij ne perputhje me sa parashikohet ne kontrate.

h) Ne rastet kur njeri prej ortakeve ka per qellim te transferoje pjeset e tij ai do ti paraqes Administratoreve nje deklarate me shkrim te te transferuarit duke pohuar qe i

transferuari do te respekoje kushtet e kesaj kontrate.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqerise jane :

Asambleja e ortakeve.

Administratoret.

Revizoret.

NENI 9

Ortaket bien dakort qe drejtimi i shoqerise te kryhet nga dy administratore te zgjedhur nje nga TR dhe nje nga KN.

Administratoret perfaqesojne shoqerine perball te treteve dhe ne gjykim dhe per probleme te vecanta mund te ngarkojne me prokure persona te tjere.

Administratoret konfirmohen cdo 4 vjet nga Asambleja e ortakeve qe eshte organi me i larte i shoqerise. Asambleja mblidhet me kerkesen e njerit prej administratoreve me paralajmerim te pakten 1 muaj para dites se caktuar per mbledhje.

Te drejtat dhe kopetencat e administratoreve jane te percaktuara ne ankesin 1 qe i bashkangjitet statutit te shoqerise.

NENI 10

Perdorimi i stemes se KN ose Nakufreight,i emblemes ose i pjeseve te tjera te identitetit te korporuar te KN nga ana e shoqerise,kerkon me pare miratimin me shkrim nga KN.

NENI 11

TR do te transferoje ne shoqeri te gjitha aktivitetet e transportit,do te shtrije veprimtarine egzistuese ne mbare boten dhe ne Shqiperi.Ne vecanti TR do te informoje te gjitha filialet per shoqerine me KN ne Shqiperi duke rekomanduar qe ne lidhje me eksportet e tyre ne Shqiperi,keto firma apo shoqeria te njihen me avantazhet qe dalin nga bashkepunimi me shoqerine Transalbaniasi agjent spedicioni.

KN do te organizoje shitjen mbare boterore kudo qe perfaq- sohet duke i rekomanduar te gjitha filjaleve ose shoqerive te saj per te kryer eksporte e importe per ne dhe nga Shqiperia me ane te shoqerise Transalbania.

KN do te jape ndihme profesionale per nepunesit e shoqerise dhe do te zbatoje sistemin EDP ne shoqeri duke vene ne dispozicion eksperienca profesionale per drejtimin dhe





aktivitetin.KN do t'i jape shoqerise magazinat e tyre dhe do te dije si behet shperndarrja ne Shqiperi.KN do te mbeshtese perkrahjen per shoqerite e lundrimit dhe te sigurimit si dhe drejtimin e kontrolluar dhe kostot e llogaritura ne perputhje me legjisacionin shqiptar.

NENI 12

Po te mos kete dhene me pare miratimin me shkrim ortaku tjeter,TR dhe KN abstenojne si fillim te shoqerise Transalbania nga zbatimi ose fillimi ne Shqiperi drejt per drejt ose indirekt i cdo veprimtarie si broker doganore,spedicionere,agjente,operator, magazine ose veprmtari tjeter qe mund te coje ne konkurence me shoqerine Transalbania.

NENI 13

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e vet per nje periudhe prej 12 vjetesh.Ky afat mund te zgjatet me miratimin e te dyja paleve por jo me vone se 6 muaj nga data e perfundimit te tij.

Shoqeria do te perfundoje kur secila pale do ti jape pales tjeter 6 muaj perpara,njoftim me ane te letres rekomande te vlefshme deri ne fund te cdo tremujori te vitit kalendarik,por jo me pare se 30 qershori 1994.Ne rastin e nderprerjes se aktivitetit te shoqerise,ortaket do te perpiqen te arrijne nje marreveshje per te ardhmen e mbajtjes se kuotave.N.q.se ortaket nuk do te arrijne nje marreveshje te tille,shoqeria do te shkrihet dhe do te mbyllte ne perputhje me ligjet ne fuqi.Ajo pushon se qeni edhe ne rastin kur dy vjetet e fundit te aktivitetit te saj nuk ka qene rentabel.Ne rastin e shperndarjes se shoqerise,Asambleja e ortakeve cakton nje ose me shume likujdatore.

NENI 14

Asnjeri prej ortakeve nuk do te jete perjegjes ne ndonje menyre per mos plotesimin ose vonesen ne plotesimin e te gjith the kontrates ose cdo pjese te saj qe eshte direkt ose indirekt per aresye te ndonje shkaku ose rrethane qe nuk mund te evitohej dhe qe ishte tej kontrollit te tij duke perfshtire pa kufizim zarrin,permbytjet,stuhite,termete,tufan,epidemi,ligje qeveritare lufta e shpallur ose jo,konflikt i armatosur ose kercenim i te njejitit lloj,veprime luftarake,mobilizim,embargo,bllokade,revolucion,trazire,grabitje ose greva.

Ortaku qe pretendon forcen madhore do te njoftoje me shkrin ortaket e tjere perkatesisht dhe pa vonese duke pohuar aresyet dhe rrrethanat e nje ngjarje te tille dhe pasojat e tyre te parashikuara se bashku,me deshmi ose deklarate me shkrim nga qeveritare apo autoritete te tjera sipas rastit.Ne momentin qe aresyet per pretendimin e forces madhore nuk egzistojne,ortaku pretendues do te lajmeroje pa vonese ortaket e tjere me shkrim.

Ortaku qe pretendon forcen madhore do ti garantohet nje periudhe per te plotesuar detyrimet e tij ne kete kontrate.Nje periudhe e tille do te jete e njejtë me periudhen gjate te ciles kane qene mbizotruese aresyet dhe rrrethanat qe shkaktuan forcen madhore.N.q.se shkaqet dhe rrrethanat e tilla do te egzistojne me shume se 6 muaj,ortaku i perfshire do te kete te drejte te heqë dore nga kontrata pa ndonje detyrim te metejshem.Ne nje raste te tille,palet e kesaj kontrate do te perpiqen te arrijne nje mareveshje ne interes te shoqerise dhe ortakeve te tjere.

#### NENI 15

Neqoftese nje kusht i kesaj kontrate do te jete pa vlore,atehere kushtet mbetese jane te vlefshme.Kushti pa vlore do te zevendesohet nga nje rregull qe afrohet sa me shume me kuptimin dhe qellimin ekonomik te kushtit pa vlore dhe te kontrates si nje e tere.

#### NENI 16

Aktiviteti finanziar i shoqerise mbylljet me 31 dhjetor te cdo viti.

#### NENI 17

Te dy TR dhe KN do te bashkepunojnë ne te gjitha aspektet dhe do te perdorin perpjekjet e tyre me te mire per te permbushur qellimet qe jane percaktuar ne kete marreveshje.

#### NENI 18

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj kontrate,ortaket do te perpiqen ti zgjidhin ne mirkuptim ndermjet tyre.Ne raste te kundert kopetente per zgjidhjen e mosmarenieve do te jete Arbitrazhi prane dhomës se Tregetise ne Paris i perbere nga tre arbitra.

Shpenzimet e arbitrazhit,duke perfshire edhe pagesat e avokateve do ti ngarkohen ortakut qe humb ceshtjen.

Kjo kontrate u perpilua ne dy ekzemplar ne gjuhen shqipe  
dhe angleze duke patur te dyja tekstet fuqi te barabarte. Per  
efekt interpretimi do te perdoret teksti ne gjuhen angleze.

Tirane, me 27.04.1994

*Andon Hila*  
PER TRANSSHQIPIN

ANDON HILA

PER KÜHNE&NAGEL

RALPH HABERZETTL

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE

NOTERIA

NR. 4951 KOL:

NR. 3052 REP

*Ralph Haberzettl*

V E R T E T I M

Sot me date 10.5.1994, ne zyren e noterise Tirane, para  
meje noteres, u paraqiten personalisht z. Andon Hila, banues ne  
Tirane, me leter njoftimi nr. EV 215942, leshuar nga zyre e gjendjes  
civile Tirane, dhe z. Ralf Friedrich Haberzettl, shtetas gjerman,  
me dokument identifikimi nr. 8262015400, per identitetin e te  
cileve u sigurova nga leter njoftimet personale dhe deklaruan  
se konrtata e mesiperme, e redaktuar jashte kesaj zyre, shpreh  
vullnetin e tyre te lire duke u neneshkruar.

Duke e pare kete veprim te bazuar ne ligj, e vertetoj  
ne firmen time.

NOTE RE

*Mimona Shkry*  
*27.04.1994*

